




INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA



18.01.2023
02/17

MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM – (MpB)

në mes të

**Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës me regjistrim
Nr: 5200122-6 –në tekstin e mëtejme i referuar si “IADK”**

dhe

Kuvendit Komunal të Shtimës në tekstin e mëtejme referuar si “Komuna e Shtimës”

I. Lënda e MpB

“IADK”-ja dhe “Komuna e Shtimës” pajtohen të rregullojnë një bashkëpunim të afërt me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë së projekteve bujqësore të realizuara nga “IADK”-ja në Komunën e Shtimës.

Kjo MpB ka qëllimin të përshkruajë bashkëpunimin në mes të “IADK”-se dhe “Komuna e Shtimës” gjatë vitit 2023, bazuar në zbatimin e projektit “**Fuqizimi i të rinjve dhe grave të zonave rurale për përfshirje në bujqësi dhe përpunim të ushqimit**” financuar nga CFD dhe zbatuar nga IADK, ndërsa projekti do të ketë shtrirje në Komunën e Vushtrrisë, Lipjanit, Shtimes dhe Mitrovicës.

Palët e lart cekura pajtohen që MpB-ja të përmbajë këto obligime dhe përgjegjësi:

II. Obligimet e IADK-së në zbatimin e projektit

- IADK do të organizoi një sesion informues përmes të cilit pjesëmarrësit do të njoftohen lidhur me qëllimin e projektit, aktivitetet e projektit, si dhe mënyrën se si mund të përfshihen në projekt;
- IADK do të organizoi pesë (5) ditë trajnime intensive dhe praktik për përgatitjen e planit të biznesit, menaxhimin e fermave dhe teknikat e prodhimit për grupin prej 15 të rinjve cilët do të përzgjedhen në bazë të kriterëve të përcaktuara në projekt;
- Përkrahja e shtatë (7) të rinjve më të suksesshëm të cilët plotësojnë kriteret e selektimit. Paketa e granteve është e hapur, prandaj të rinjtë do të aplikojnë me idetë e tyre në vlerë 2,500euro;

Adresa:

Sfaraçak i Ulët nr.11
42000 Vushtrri

*Jë jetojmë nga toka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!*

E-mail: info@iadc.org

Tel: 049777046 & 044777036

Web: www.iadc.org



- IADK do të organizoi pesë (5) ditë trajnime intensive dhe praktike mbi menaxhimin e biznesit, mbajtjen e librave, aksesin në treg, të drejtat pronësore, të drejtat e njeriut, lobimin dhe metodat e avokimit për grupin prej 15 grave/burrave të cilët do të përzgjedhen në bazë të kriterëve të përcaktuara në projekt;
- Përkrahja e tetë (8) grave/burrave më të suksesshëm të cilët plotësojnë kriteret e selektimit. Paketa e granteve është e hapur, prandaj gratë/burrat do të aplikojnë me idetë e tyre në vlerë 2,500euro;
- IADK do të organizoi vizitë 1-ditore në Kosovë, për të gjithë kandidatët që kanë përcjellur trajnimet;
- IADK në bashkëpunim me përfaqësuesit nga Komuna e Shtimës do të bëjë përzgjedhjen e përfituesëve të granteve;
- IADK do të furnizojë me të mira të nevojshme përfituesit e projektit;
- IADK do të monitorojë dhe mbikëqyrë aktivitetin e “Përfituesëve”;
- IADK do të organizojë këshilla direkte për përfituesit e grantit, për të përgatitur dhe menaxhuar sa më mirë punët rreth aktiviteteve të tyre bujqësore;
- IADK-ja do të punojnë ngushtë me Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik - Sektorin për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural të Komunës Shtime në monitorimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të përfituesëve;

III. Obligimet e “Komunës së Shtimes” në përkrahjen e zbatimit të projektit

- “Komunën e Shtimës” dhe “IADK”-ja pajtohen që të përkrahin njëra-tjetrën në zbatimin e projektit në interes të “Komunës së Shtimës” dhe “IADK”-së dhe të cilat zbatohen në “Komunën e Shtimës”;
- “Komuna e Shtimës” do të përkrahë “IADK”-në në bashkëfinancimin e projektit;
- “Komuna e Shtimës” do të bashkëfinancojë projektin të përfituesit e granteve për gratë/burrat dhe njësisë përpunuese me 20 % të investimit (shih tabelen 1);
- “Komuna e Shtimës” së bashku me “IADK” do të organizojë sesionet informuese, duke informuar shoqatat, fermerët, grave dhe burrat të regjistruara në databazën e komunës;
- “Komuna e Shtimës” do t’i ndihmojë “IADK”-së në organizimin e grupeve për trajnimet në sektorin e bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit;
- “Komuna e Shtimës” do të ndihmojë në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të granteve dhe përpunimit të ushqimit;
- “Komuna e Shtimës” mund të monitorojë dhe mbikëqyrë aktivitetet e “Përfituesëve” edhe pas përfundimit të projektit;
- “Komuna e Shtimës” do të asistojë IADK-në në organizimin e panairit duke mundësuar lejimin e hapësirës publike, nëse panairi organizohet në Komunën e Shtimës.

Tabela 1, Kostoja e bashkëfinancimit për grante përkrahëse për përfituesit - kontributi i palëve

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Njësia	Nr. i përfituesëve	Investimi €/përfitues	Totali €	Pjesëmarrja e partnerëve		
						IADK dhe Donatorët	Komuna Shtime	Përfituesit
1	Përkrahje e të rinjve me grante në sektorin e bujqësisë	Fermer	7	2,500.00	17,500.00	12,250.00	3,500.00	1,750.00
2	Përkrahje e grave/burrave me grante në sektorin e bujqësisë	Fermerë	8	2,500.00	20,000.00	14,000.00	4,000.00	2,000.00
Total direkte					37,500.00	26,250.00	7,500.00	3,750.00
3	Shpenzimet e ekspertëve (stafit) operacionale: këshilla direkte, trajnime, komunikime, materiale edukuese, raportimet dhe monitorimet sipas kontratës me përfitues				11,250.00	9,000.00	2,250.00	-
Buxheti total					48,750.00	35,250.00	9,750.00	3,750.00
						IADK	Komuna	Fermeri
						72%	20%	8%
						Investimi total në Komunë		48,750.00

IV. Mënyra e pagesës së bashkëfinancimit nga Komuna e Shtimës

- “Komuna e Shtimës” do t’i bëjë pagesën IADK-së për bashkëfinancim gjatë vitit 2023, pas zbatimit të projekteve dhe dorëzimit të raportit final për mbështetjen e lartë cekur, listën e përfituesve dhe kërkesës për pagesë, nga ana e IADK-së;
- Pagesa do të bëhet në TEB Bankë në depozitim në **Nr.xhir:2027-000021-7128-84**, në emër të IADK-së;
- Te pika 1,2 numri i përfituesve të granteve është tentativë, dhe mund të rritet ose zvogëlohet varsishte nga interesimi i kandidatëve dhe plotësimi i kriterëve të përcaktuara me projekt;**
(Sqarim shtesë: vlera e grantit për një përfitues është mesatarisht 3,250€ duke përfshirë këshilla direkte, trajnime, komunikime, materiale edukuese, raportimet dhe monitorimet. Andaj, për çdo përfitues që shtohet ose largohet shuma mund të shtohet ose zbritet nga totali i përgjithshëm, për kontributin e komunës me vlerë 650.00€)
- Varësisht nga numri i përfituesve dhe vlera e investimit në Komunën e Shtimës, do të bëhet edhe bashkëfinancimi (por nuk do të kalojë vlerën 20% nga investimi total nga Komuna e Shtimës).
- Përzgjedhja e përfituesve do të bëhet nga komisioni i përbashkët i IADK-së dhe Komunës së Shtimës, poashtu kontratat me përfituesit e projektit do të nënshkruhen nga tri palët (IADK, Komuna dhe përfituesi);

V. Përgjegjësit të tjera

- “IADK” do të njoftoj në mënyrë të rregullt dhe do të raportoj në fund të projektit tek “Komuna e Shtimës” për rezultatet e arritura nga aktivitetet e realizuara në kuadër të MpB;
- “IADK” do të njoftoj me kohë “Komunën e Shtimës” për mundësinë e vazhdimet të MpB për vitin 2022;